

Cili shtet është përgjegjës për aplikimin tuaj

Procedura e Dublinit

Pse ju është dhënë kjo broshurë?

Ju keni aplikuar për azil në Holandë. Sidoqoftë, me sa duket nga hetimi i kryer nga Vreemdelingenpolitie (Policia për të Huajt) (Departamenti i Policisë për të Huajt, Identifikimi dhe Trafikimi i Personave, shkurt AVIM) dhe/ose Policia Ushtarake Mbretërore Holandeze, një shtet tjetër mund të jetë përgjegjës për trajtimin e aplikimit tuaj për azil.

Mund të ketë arsye të ndryshme për këtë. Për shembull:

- Keni paraqitur dokumente pranë Policisë për të Huajt ose Policisë Ushtarake Mbretërore Holandeze që tregojnë se keni shkuar në një shtet tjetër evropian në fillim para se të vinit në Holandë ose se keni një vizë për një shtet tjetër evropian. Kjo mund të nënkuptojë se ai shtet është përgjegjës për trajtimin e aplikimit tuaj për azil.
- Policia për të Huajt ose Policia Ushtarake Mbretërore Holandeze ka regjistruar gjurmët tuaja të gishtave dhe ka kontrolluar nëse ato shfaqen në Eurodac ose EUVIS. Eurodac dhe EUVIS janë sisteme kompjuterike që përmbajnë të gjitha gjurmët e gishtave të atyre personave që kanë aplikuar për azil ose për një vizë në një shtet evropian. Në këtë mënyrë, mund të kontrollohet nëse keni aplikuar për një vizë ose për azil në një shtet tjetër evropian. Rrjedhimisht, ai shtet mund të jetë përgjegjës për trajtimin e aplikimit tuaj për azil.

Tani Shërbimi për imigrimin dhe natyralizimin (IND) duhet të hetojë nëse një shtet tjetër është vërtet përgjegjës për trajtimin e aplikimit tuaj për azil. Si rezultat, procedura juaj e azilit do të ndjekë një rrugë tjetër nga ajo që përshkruhet në broshurat “Para fillimit të procedurës së azilit” dhe “Aplikimi juaj për azil”. Kjo broshurë ju shpjegon ato ndryshime.

Intervista e Dublinit

Do të zhvilloni një intervistë zyrtare me një përfaqësues të shërbimit IND në lidhje me identitetin tuaj, kombësinë dhe udhëtimin tuaj për në Holandë. Përfaqësuesi do t'ju tregojë rezultatet e hetimit për dokumentet tuaja dhe gjurmët e gishtave dhe do t'ju bëjë po ashtu disa pyetje për këto. Këto pyetje nuk do të jenë për arsyet se pse jeni larguar nga vendi juaj i origjinës. Në këtë intervistë mund të thoni se pse mendoni se Holanda duhet të trajtojë aplikimin tuaj për azil dhe të shprehni çdo kundërshtim që mund të keni ndaj transferimit në një shtet tjetër.

Një përkthyes do të jetë i pranishëm në intervistën e IND-së. Përfaqësuesi i IND-së do t'i bëjë pyetjet në holandisht. Përkthyesi do t'i përkthejë këto pyetje në një gjuhë që ju e kuptoni. Përkthyesi do të përkthejë më pas përgjigjet tuaja në holandisht. Përkthyesi është i pavarur dhe nuk ka ndikim në vendimin për aplikimin tuaj për azil. Informoni menjëherë nëse ju dhe përkthyesi nuk mund ta kuptoni si duhet njëri-tjetrin. Në një rast të tillë, IND-ja do të sigurojë një përkthyes tjetër. Është e rëndësishme që të mos lindin keqkuptime për shkak se nuk i keni kuptuar si duhet pyetjet.

Pas kësaj interviste, IND-ja do të vlerësojë nëse një shtet tjetër është përgjegjës për trajtimin e aplikimit tuaj për azil. Rezultati i këtij vlerësimi është vendimtar për vijimësinë e procedurës tuaj të azilit. Ka dy rezultate të mundshme

1. IND-ja vlerëson se Holanda është përgjegjëse për trajtimin e aplikimit tuaj për azil. Procedura juaj e azilit do të vazhdojë më pas siç përshkruhet në broshurën "Aplikimi juaj për azil".
2. IND-ja vlerëson se një shtet tjetër është përgjegjës për trajtimin e aplikimit tuaj për azil. IND-ja do t'i kërkojë më pas këtij shteti tjetër që të marrë përsipër procesin e trajtimit të aplikimit tuaj për azil. Mund të lexoni më poshtë se si, në një rast të tillë, procedura e Dublinit do të vazhdojë tani në Holandë.

Vendimi i planifikuar

Do të merrni një letër nga IND-ja (nëpërmjet avokatit tuaj) që deklaron se IND-ja nuk ka si qëllim (= nuk planifikon) të trajtojë aplikimin tuaj për azil. Kjo do të thotë se IND-ja nuk do të trajtojë në thelb aplikimin tuaj për azil, por këtë do të duhet ta bëjë një shtet tjetër në vend të saj. Kjo letër do të përcaktojë po ashtu arsyet për këtë refuzim të planifikuar dhe shpjegon pasojat e kësaj për ju.

Diskutimi i intervistës e këndvështrimit

Avokati do të diskutojë me ju për raportin e intervistës dhe vendimit të pritur. Një përkthyes do të jetë po ashtu i gatshëm gjatë këtij takimi për të përkthyer çdo gjë që thuhet nga ju dhe avokati juaj. Avokati juaj do t'i dërgojë një letër IND-së për t'i njoftuar ata nëse mungon ndonjë gjë nga raporti ose nëse diçka është regjistruar gabim. Avokati mund t'i dërgojë po ashtu IND-së një "këndvështrim" me shkrim. Kjo është një letër ku ju jepni përgjigjen tuaj zyrtare për vendimin e planifikuar të IND-së dhe ku deklaroni se pse nuk jeni dakord me të.

Vendimi i IND-së

Pasi IND-ja ta ketë lexuar reagimin tuaj për vendimin e saj të planifikuar, ajo do të vendosë nëse ky vendim i planifikuar duhet të ndryshohet. Rezultati i këtij vlerësimi është vendimtar për vijimësinë e procedurës tuaj të azilit. Ka dy mundësi:

1. IND-ja vlerëson përsëri se një shtet tjetër është përgjegjës për trajtimin e aplikimit tuaj për azil dhe ky shtet tjetër është i përgatitur për të marrë përsipër trajtimin e aplikimit tuaj për azil nga Holanda.
Do të merrni një letër (= vendimin) nga IND-ja (nëpërmjet avokatit tuaj) që deklaron se aplikimi juaj për azil nuk do të trajtohet në Holandë. Ju do të merrni po ashtu informacione të veçanta me këtë letër, ku informoheni për pasojat e këtij refuzimi, çfarë hapash mund të merrni dhe cilat janë mundësitë për kthimin që janë të hapura për ju. Ky vendim përcakton po ashtu arsyet për këtë refuzim dhe shpjegon pasojat e kësaj për ju. Avokati do të diskutojë me ju për këtë vendim.
2. Pas leximit të këndvështrimit tuaj, IND-ja vlerëson si përfundim se Holanda është përgjegjëse për trajtimin e aplikimit tuaj për azil. IND-ja do të fillojë të trajtojë aplikimin tuaj për azil në Procedurën e përgjithshme të azilit. Më pas do të merrni një broshurë tjetër me më shumë informacione për Procedurën e përgjithshme të azilit.

Pas vendimit të Dublinit

Nëse një shtet tjetër është përgjegjës për trajtimin e aplikimit tuaj për azil, atëherë IND-ja do t'i kërkojë atij shteti tjetër që të marrë përsipër procesin e trajtimit të aplikimit tuaj për azil. Kjo quhet një "kërkesë për referim ose kthim". Nëse ky shtet e pranon atë kërkesë, IND-ja do t'i kërkojë më pas Shërbimit të Riatdhesimit dhe Largimit që të organizojë udhëtimin tuaj për në atë shtet; kjo do të thotë se ju do të dërgoheni në atë shtet. Kjo do të organizohet për ju brenda gjashtë muajve pasi ai shtet të ketë pranuar kërkesën e referimit ose të kthimit. Mund të diskutoni me avokatin tuaj nëse dëshironi ta apelon vendimin e IND-së për transferimin e aplikimit tuaj për azil te një shtet tjetër. Apeli nënkupton se ju po i drejtoheni zyrtarisht gjykatës se nuk jeni dakord me vendimin e IND-së. Në parim, nuk mund të qëndroni në Holandë gjatë kohës që prisni vendimin e gjykatës, por mund t'i kërkonit po ashtu gjykatës nëse mund të qëndroni në Holandë gjatë procedurës së apelit. Avokati juaj do t'ju ndihmojë për këtë. Më pas gjykata do të shqyrtojë nëse IND-ja i ka zbatuar si duhet ligjet holandeze dhe Rregulloren e Dublinit kur ka vendosur për aplikimin tuaj për azil.

Cila organizatë do të merret me ju?



COA Centraal Orgaan opvang asielzoekers

Centraal Orgaan opvang asielzoekers (Agjencia Qendrore për Pritjen e Azilkërkuessve, COA) është përgjegjëse për akomodimin dhe udhëzimet për azilkërkuessit në Holandë. Agjencia COA siguron që t'ju ofrohet një strehim, ushqime dhe siguri shëndetësor. Agjencia COA mund t'ju ndihmojë po ashtu nëse keni nevojë të kontaktoni me një doktor. Agjencia COA është një organizatë e pavarur dhe nuk merr vendime për aplikimin tuaj për azil.



GezondheidsZorg Asielzoekers (GZA) (Kujdesi Shëndetësor për Azilkërkuessit) është organizata e kujdesit shëndetësor që mund t'ju ndihmojë nëse jeni të sëmurë ose nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me shëndetin tuaj. Në ose në afërsi të çdo qendre pritjeje të COA-s ka një qendër të GZA-së. Ajo mund të organizojë një takim me një ndihmësmjek, infermier, një mjek ose një infermier të kujdesit shëndetësor mendor. Ata kanë një linjë ndihme 24-orëshe, linjën Praktijklijn, ku mund të telefononi nëse keni ndonjë pyetje mjekësore: 088 112 21 12. Mund të telefononi po ashtu në këtë numër për çdo pyetje tjetër në lidhje me shëndetin tuaj nga dita e hënë deri të premtën, për shembull, nëse keni nevojë për një rekomandim për te një specialist.



VluchtelingenWerk Nederland (Këshilli Holandez për Refugjatët) është një organizatë e pavarur për të drejtat e njeriut, qëllimi i së cilës është të mbrojtë të drejtat e azilkërkuessve. Këshilli Holandez për Refugjatët mund t'ju japë informacione dhe t'ju shpjegojë procedurën e azilit dhe ata janë të pranishëm personalisht për t'ju informuar dhe për t'ju mbështetur kur ndiqni procedurën e azilit; ata mund t'ju ndihmojnë po ashtu nëse keni probleme me organizatat e tjera. Këshilli bashkëpunon ngushtë me avokatin tuaj. Këshilli Holandez për Refugjatët nuk merr pjesë në vendimin për aplikimin tuaj për azil.

Raad voor Rechtsbijstand *legal aid*

Raad voor Rechtsbijstand (Bordi i Ndihmës Ligjore) siguron që të merrni ndihmën e një avokati nëse nuk mund ta paguani vetë një të tillë. Avokati është një këshilltar i pavarur ligjor, i cili është i gatshëm t'ju ndihmojë gjatë procedurës së azilit, dhe ai nuk është i punësuar nga Bordi i Ndihmës Ligjore. Avokati do të marrë një pagesë nga Bordi i Ndihmës Ligjore për ndihmën që ju ofron.



Immigratie- en Naturalisatiedienst
Ministerie van Veiligheid en Justitie

Immigratie-en Naturalisatiedienst (Shërbimi i Imigracionit dhe Natyralizimit, IND) është pjesë e Ministrisë të Drejtësisë dhe Sigurisë së Holandës. Anëtarët e personelit të IND-së do të zhvillojnë intervista me ju në lidhje me identitetin tuaj, kombësinë, udhëtimin tuaj për në Holandë dhe arsyet pse jeni larguar nga vendi juaj. Ata do të vlerësojnë historinë tuaj personale dhe situatën në vendin tuaj të origjinës. Më pas ata do të vendosin nëse mund të qëndroni në Holandë - ndonjëherë për një periudhë të përkohshme - ose nëse duhet të ktheheni në vendin tuaj.



Në ndërtesat e IND-së dhe në qendrat e pritjes të COA-s ka roje sigurie. Mund t'i dalloni nga uniforma e tyre. Ata janë aty për të ruajtur sigurinë tuaj. Mund t'u drejtoni atyre pyetje në lidhje me ato që mund ose nuk mund të bëni në qendrat dhe në ndërtesat e COA-s dhe IND-së. Këto roje sigurie nuk kanë ndikim në vendimin për aplikimin tuaj për azil.



Dienst Terugkeer en Vertrek
Ministerie van Veiligheid en Justitie

Dienst Terugkeer en Vertrek (Shërbimi i Riatdhesimit dhe Largimit, DT&V) është pjesë e Ministrisë së Drejtësisë dhe Sigurisë së Holandës. Nëse aplikimi juaj për azil refuzohet nga IND-ja, një anëtar i personelit të DT&V-së do t'ju ndihmojë për organizimin e riatdhesimit tuaj në vendin e origjinës.



Internationale Organisatie voor Migratie (Organizata Ndërkombëtare për Migracionin) (IOM) është një organizatë e pavarur që mbështet migrantët në të gjithë botën. Ajo do t'ju ndihmojë nëse dëshironi të largoheni nga Holanda me iniciativën tuaj. Organizata IOM mund t'ju japë informacione praktike për kthimin dhe riintegrimin në vendin tuaj dhe do t'ju ndihmojë për organizimin e largimit nga Holanda. Mund të pyesni një nga ndihmësit nga Këshilli Holandez për Refugjatët ose avokatin tuaj për t'ju ndihmuar.

Përpunimi i të dhënave tuaja personale

Të dhënat personale janë të gjitha llojet e informacioneve për ju. Organizatat që kanë bashkëpunuar për këtë broshurë janë të renditura më poshtë. Këto organizata i administrojnë të dhënat personale gjatë përpunimit të aplikimit, të njoftimit ose të kërkesës suaj. Ato ju pyesin për detajet tuaja dhe pyesin po ashtu organizata të tjera ose persona të tjerë për këto, nëse është e nevojshme. Këto organizata i përdorin dhe i ruajnë detajet tuaja dhe i transmetojnë ato tek organizatat e tjera nëse kjo kërkohet nga ligji. Legjislacioni për privatësinë përfshin detyrime për organizatat që përpunojnë të dhënat tuaja. Për shembull, ato duhet t'i administrojnë të dhënat tuaja në mënyrë të sigurt dhe me kujdesin e duhur. Ligjet për privatësinë kanë përcaktuar po ashtu të drejtat tuaja, për shembull:

- për t'u këshilluar për të dhënat që mbahen nga organizatat;
- për të ditur se çfarë bëjnë organizatat me të dhënat tuaja dhe arsyen pse;
- për të ditur se cilave organizata u janë transmetuar të dhënat tuaja.

Dëshironi të dini më shumë për përpunimin e të dhënave tuaja personale dhe të drejtat tuaja? Shikoni faqet e internetit të organizatave. Adresat e uebit mund t'ju gjeni më poshtë.

Pyetjet e shpeshta

Ku do të qëndroj gjatë procedurës së Dublinit?

Pasi të keni kaluar procedurën në qendrën e aplikimit, do të qëndroni në qendrën e azilkërkuesve. Nëse më vonë IND-ja vendos të trajtojë në thelb aplikimin tuaj, do të transferoheni në një Qendër të pritjes për përpunimin (POL) dhe më pas do të ndiqni Procedurën e përgjithshme të azilit.

Keni ende pyetje pas leximit të kësaj broshure?

Këto pyetje mund t'ua drejtoni avokatit tuaj ose një prej anëtarëve të personelit të COA-s, IND-së ose të Këshillit Holandez për Refugjatët.

Keni ndonjë ankesë?

Të gjitha organizatat që janë të përfshira në procedurën e azilit punojnë me kujdes dhe në mënyrë profesionale, por mund të paraqisni një ankesë nëse mendoni se nuk jeni trajtuar si duhet nga një prej organizatave. Avokati juaj ose dikush nga Këshilli Holandez për Refugjatët mund t'ju ndihmojnë për këtë.

Ky botim është një prodhim i përbashkët nga:

Agjencia Qendrore për Pritjen e Azilkërkuesve | www.coa.nl

Shërbimi i Riatdhesimit dhe Largimit |

www.dienstterugkeerenvertrek.nl

Shërbimi i Imigracionit dhe Natyralizimit | www.ind.nl

Bordi i Ndihmës Ligjore | www.rvr.org

Këshilli Holandez për Refugjatët | www.vluchtelingenwerk.nl

Porositur nga:

Drejtoria për Politikën e Migrimit në Drejtësisë dhe Sigurisë dhe Drejtësisë www.rijksoverheid.nl

Nga përmbajtjet e këtij botimi nuk përftohet asnjë e drejtë. Nëse përkthimi sjell ndryshime interpretimi, versioni në holandisht do të ketë përparësi.